



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren  
SENATI

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Prenuar me dt.	24.12.2018
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-297

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 24.12.2018, vendosi në mënyrë unanime nga anëtarët prezent që të dalë me këtë deklaratë të përbashkët.

### DEKLARATË

1. Përkrahim në tërësi të gjitha kërkesat e Parlamentit Studentor.
2. Distancohemi nga veprimet e anëtarëve të KD të emëruar nga MASHT dhe anëtarit të shkarkuar nga senati.
3. Senati autorizon organet përkatëse që të ushtrojnë ankesë në Inspektoratin e Punës në Prizren dhe MASHT ndaj vendimit të nxjerrë nga 4 anëtarë të KD për UD rektor.
4. Senati fton komisionin në kuadër të UPZ që të vlerësojë se a kemi konflikt interesi me zgjedhjen e UD rektorit të Prof. asoc. dr. Ismet Temaj, kur kemi një vendim të Gjykatës rreth kësaj çështje.
5. Senati fton të njëjtin komisionin që të vlerësojë se a kemi konflikt interesi për anëtarin e KD z. Parim Kosova, pasi ky i fundit ka disa marrëdhënie të rregullta pune.
6. Konsiderojmë se fajtori kryesor për zhvillimet e fundit në UPZ janë anëtarët e KD të emëruar nga MASHT, prandaj kërkojmë nga MASHT shkarkimin e tyre.
7. Kërkojmë respektimin e autonomisë së Universitetit e cila së fundi na është cenuar.
8. Kërkojmë nga partitë në pushtet që t'i heqin duart një herë e mirë nga UPZ-ja.
9. Kërkojmë që UD rektori të zgjedhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe në mënyrë demokratike.
10. Ftojme prokurorinë e shtetit që të hetojë anëtarët e KD për keqpërdorim të detyrës zyrtare me rastin e zgjedhjes UD rektor.
11. Mbështesim 3 anëtarët e KD të zgjedhur nga Senati në veprimet e tyre për të mos u bërë pjesë e shkeljeve që ky organ po i bën në vazhdimësi.
12. Japim premtim publik para studentëve se si Senatorë do të mbrojmë interesin e Universitetit me të gjitha mundësitë tona.

Kryesues i Senatit – anëtari më i vjetër

  
Prof. asoc. dr. Fahredin Shabani

*Shënim: Shtojcë të kësaj deklarate keni kërkesat e Parlamentit Studentor.*